



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKI KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - URBETI PRIME MINISTRI - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Nësta Org. Org. Unit	02.10	Nr. Proc. Proc. No.	1466
Nr. ffaqeve No. pages	- 2 -	Data: Date:	11 / 11 / 20 24
Prishtinë/a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 11.11.2024

Mbledhja e 230 e Qeverisë e Republikës së Kosovës mbahet më 13.11.2024, në orën 10:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 223, 226 dhe 227 dhe ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet: 224, 225 dhe 228 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien e mendimit lidhur me Nismën Legjislative të Kuvendit për "Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale" (ZKM)
3. Shqyrtimi i Projekt-rregullores për Performancë Rajonale dhe Monitorim të Zhvillimit Socio Ekonomik Rajonal të Balancuar (MZHR)
4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të kërkuara nga Komuna e Shtimes të menaxhuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës për realizimin e disa projekteve kapitale (MAPL)
5. Shqyrtimi i Draftit të Planit Kombëtar të Veprimit për Transpozimin e Direktivës për Shërbime në Tregun e Brendshëm për Periudhën 2024 - 2026, sipas Ligjit për Shërbime (MINT)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/128 të datës 16 shkurt 2023, lidhur me "Komisionin për Përfitimin e Shtesës për Kushte Specifike të Punës" (MFPT)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Masës 2.2 - Mbështetje bizneseve për qasje në financa të Pakos së Ringjalljes Ekonomike (MFPT)
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtim të mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25" (MMPHI)
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për Ekspertët (MPB)

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike (MPB)
11. Shqyrtimi i Draftit të Strategjisë Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 (MSH)
12. Shqyrtimi i Nismës për lidhjen e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bashkimit Evropian të përfaqësuar nga Komisioni Evropian dhe Bankës Qendrore të Kosovës si agjent i Qeverisë për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (MFPT)
13. Shqyrtimi i Draftit të Raportit nëntë (9) mujor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2024 (MFPT)
14. Të ndryshme